



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nr. Prot. 734

Tiranë, më 29 Tetor 2021

**Drejtuar:** Z. Bledar Çuci  
Ministër  
Ministria e Brendshme

**Për dijani:** SHTZ. Yuri Kim  
Ambasadore e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri

SHTZ. Luigi Soreca  
Ambasador i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri

Z. Pablo Zapata  
Përfaqësues i Zyrës së UNHCR-së në Shqipëri

**Lënda:** Përcillen sugjerimet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit për projekt-vendimin e Këshillit të Ministrave “Për kriteret e emërimit, shkaqet e lirimit apo të shkarkimit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të komisionit kombëtar për azilin dhe refugjatët”

**I nderuar Ministër,**

Në vijim të dërgimit të projekt vendimit të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e emërimit, shkaqet e lirimit apo të shkarkimit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) vlerëson faktin se, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i organizatës tonë në përbërje të këtij organi kolegjal, daton herët në kohë, pavarësisht se ndryshimet në legjislacion kanë sjellë që statusi ynë si anëtar jo gjithmonë ka reflektuar qëndrueshmëri nga pikëpamja kohore.

Vlen të evidentohet se në misionin e KShH-së, ashtu sikurse është parashikuar dhe në aktin e themelimit dhe statutin e tij, një nga shtyllat më të rëndësishme të veprimtarisë tonë është vëzhgimi i gjendjes së të drejtave dhe lirisive themelore të njeriut si dhe zbatimi i parimeve të shteti ligjor, denoncimi i çdo shkeljeje që bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të njohura përgjithësisht. Në përmbushje të misionit tonë, pavarësisht

Adresa: Rr. “Brigada e VIII”, Pall. TeknoProjekt  
AP.10, Kati 5 Tirana- Albania  
P.O Box/ Kutia Postare No.1752

Tel & Fax: +355 (0) 4 233 671  
e-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al)  
Web address: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

se ky organ kolegjal është vendimmarrës dhe ka natyrë *quasi gjyqësore*, jemi munduar të kontribuojmë sadopak me oponencë ligjore konstruktive, në ato çështje të ankmuara nga azilkërkuesit, sikurse ka qenë edhe rasti i Selami Simsek, kur vendimmarrja e anëtarit përfaqësues të KShH ka qenë e ndryshme nga ajo e anëtarëve të shumicës. M gjith, vlen gjithashtu të theksohet se në mendimin tonë në pakicë, jemi bazuar dhe udhëhequr ndër të tjerash, nga standartet dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, për gëzimin dhe ushtrimin efektiv të të drejtave të azilkërkuesve si dhe në përputhje me garancitë e nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që sanksionon të drejtën për proces të rregullt.

Nëse komentet dhe sugjerimet tona do të vlerësohen parimisht, KShH dëshiron të evidentojë faktin se angazhimi ynë në këtë Komision do vijojë të jetë në përputhje me misionin e organizatës dhe në respektim të plotë të pavarësisë tonë organizative (të brendshme dhe të jashtme), të mbrojtur nga neni 10 dhe 11 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Sa më sipër, duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm konstruktiv me Ministrinë e Brendshme, lutemi gjeni në vijim të kësaj shkrese, komentet dhe sugjerimet e KShH-së për projekt-vendimin e përcjellë.

Për sa i takon kritereve të emërimit, të parashikuara në pikën 7 të projekt-vendimit, KShH vëren se:

- Është e paqartë se cilat janë pozicionet ekuivalente jashtë shërbimit civil dhe kush janë institucionet e barazvlefshme të administratës shtetërore, sa kohë anëtari që vjen nga shoqëria civile, përkatësisht KShH, mund të plotësojë kriterin e përvojës, për të cilin jemi dakord që të jetë jo më pak se 5 vjet punë, por jo detyrimisht atë të mbajtjes së pozicioneve publike apo të barazvlefshme me to. Lutemi të mbani në konsideratë përshtatjen e kritereve për anëtarin përfaqësues të KShH-së si një organizatë e shoqërisë civile vendase, dhe faktin se këto kritere mund të jenë penguese apo të kenë efekt përjashtues për KShH.
- Në po këtë pikë, në gërmën "d" është specifikuar kriteri për të patur çertifikatë sigurie, të nivelit "sekret". Pajisja me një çertifikatë të tillë, për anëtarin përfaqësues të KShH-së nuk është në pajtim me misionin e organizatës dhe do të krijonte premisa për cënimin e lirisë sonë të organizimit, pasi nënkupton që ky anëtar ti nënshtrohet për efekt të garantimit të sigurisë, kontrolleve njësoj si funksionarë apo nëpunës publikë, ndërkohë që KShH është një organizatë e pavarur dhe e pananshme, jo fitimprurëse dhe jo politike. Rrjedhimisht çdo formë kontrolli për të dhënat e anëtarit përfaqësues të KShH-së në Komision, që rrjedh nga detyrimet e parashikuara në legjisllacionin në fuqi për



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

pajisjen me certifikatë të tillë sigurie, mund të krijonte premisa për ndikim të papërshtatshëm dhe cënim të lirisë organizative të KShH-së. Në këtë kontekst, KShH vlerëson se do të ishte më e drejtë të parashikohej që anëtari përfaqësues i KShH-së në Komision të rezultojë i padënuar penalisht (kriter ky që mund të shtohet edhe për anëtarët e tjerë) si dhe të nënshkruajë një deklaratë ku pranon detyrimin për respektimin e të dhënave të klasifikuara si “sekret shtetëror” dhe rrjedhimisht mospërcjelljen e tyre tek të tretët.

Në pikën 9 të projektvendimit janë parashikuar rastet e shkarkimit nga detyra të anëtarit të Komisionit. Lidhur me këtë pikë, KShH vëren se:

- lidhur me germën “b” e cila parashikon shkarkimin në rastet kur *“veprimet apo mosveprimet e anëtarit kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë e Komisionit”*, sugjerojmë që të saktësohen cilat janë këto veprime apo mos veprime, çfarë do të konsiderohet dëm i rëndë, si do të zhvillohet procesi për shkarkimin e anëtarit, cilat janë të drejtat që duhet ti garantohen atij/asaj përgjatë këtij procesi, dhe ku duhet të ankohet ndaj vendimit të shkarkimit. Kjo për arsye të shmangies së rasteve subjektive dhe të njëanshme të shkarkimit si dhe për të garantuar të drejtën për proces të rregullt ligjor ndaj anëtarit të Komisionit që dyshohet se ka kryer këto veprime apo mosveprime.
- për parashikimin *“anëtari i Komisionit mund të shkarkohet nga detyra, ndër të tjerash kur nuk ruan konfidencialitetin e informacioneve”* (gërma c), KShH sugjeron riformulimin e saj, duke u bazuar në Ligjin tonë në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, deri në momentin e shpalljes së vendimit nga Komisioni. Pas këtij momenti, detyrimi për konfidencialitetin në vlerësimin tonë duhet të ekzistojë vetëm për të dhëna që janë klasifikuar si “sekret shtetëror” dhe njëkohësisht, nuk janë pjesë e vendimit të shpallur të arsyetuar, i cili duhet të bëhet publik sa kohë Komisioni është një organ *quasi gjyqësor* që shqyrton në ankimet e azilkërkuesve ndaj vendimeve të Drejtorisë së Azilit. Të dhënat personale të azilkërkuesit mund të anonimizohen në vendimin e Komisionit, nëse azilkërkuesi apo përfaqësuesi i tij ligjor me tagra përfaqësimi të plota, nuk pranon publikimin e tyre, kundrejt detyrimit të anëtarëve të Komisionit për tja komunikuar këtë të drejtë reserve azilkërkuesit apo përfaqësuesit ligjor të tij/saj, paraprakisht gjatë shqyrtimit të ankimit.

Për sa i takon pikës 10.4, është parashikuar se kryerja e pagesës për anëtarët (por edhe për anëtarin përfaqësues të KShH-së) do të përballohet nga ***buxheti i institucioneve të secilit prej tyre*** (dmth nga KShH). Kjo do të thotë se KShH ka një detyrim të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për të bërë pagesën e anëtarit përfaqësues të tij. Lidhur me pagesën e anëtarit të



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

KShH-së, do të sugjeronim që kjo të mos specifikohet në VKM pasi është një angazhim që ne e kemi pranuar, e kemi realizuar në mënyrë vullnetarë dhënien e kontributit (pa pagesë) dhe do vijojmë ta realizojmë në këtë mënyrë, nëse sugjerimet dhe komentet tona parimore për këtë projekt-vendim do të merren në konsideratë.

Për sa i takon parashikimit të pikës “12” dhe “13” të projekt vendimit, kemi mendimin se këto çështje nuk janë në fushën e rregullimit që mbulon ky projekt-vendim dhe duhet të parashikohen në rregulloren e Brendshme të Komisionit, në përputhje me ligjin nr.10/2021 ‘Për Azilin në Republikën e Shqipërisë’ dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë në këtë fushë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm!

Me konsideratë,

**Erida Skëndaj**  
**Drejtoreshë Ekzekutive**  
**Komiteti Shqiptar i Helsinkit**